



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 30 maj 2024
Nr. ref.:RK 2436/24

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI26/24

Parashtrues

Rrahim Ramadani

Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktit të paspecifikuar të autoritetit publik

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Rrahim Ramadani, nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk specifikon se cilin akt konkret të autoritetit publik e konteston para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij nuk saktëson se cila e drejtë e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) i është shkelur.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 2 shkurt 2024, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatë.
6. Më 7 shkurt 2024, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë kërkesë për sqarim dhe njoftim rreth lëndës së tij si dhe bashkëngjiti dokumente shtesë lidhur me rastin.
7. Më 12 shkurt 2024, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [GJR. KI26/24] caktoi gjyqtarin Enver Peci, gjyqtar raportues, ndërkaq përmes Vendimit [Nr. KSH. KI26/24] caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Remzije Istrefi-Peci (anëtarë).
8. Më 16 shkurt 2024, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 22 shkurt 2024, Gjykata i kërkoi parashtruesit të kërkesës që të njoftojë Gjykatën se (i) cilin vendim të autoritetit publik e konteston para Gjykatës; (ii) të specifikojë se cilat të drejta dhe liri kushtetuese pretendon se i janë cenuar; si dhe (iii) të dorëzojë vendimin e fundit të kontestuar së bashku me vendimet tjera apo dokumentet e nevojshme që kanë të bëjnë me këtë kërkesë.
10. Më 4 mars 2024, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë përgjigje përmes së cilës theksoi se kërkon kompensimin e diferencës në pagë si dhe bashkëngjiti disa dokumente. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk specifikoi se cilin akt të autoritetit publik e konteston dhe as nuk saktësoi se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutë i janë cenuar.
11. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.

12. Më 30 prill 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që të refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e fakteve

13. Gjykata rikujton se më 18 shtator 2014, parashtruesi i kërkesës për herë të parë iu drejtua Gjykatës me kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit [CA. nr. 2862/2014] të Gjykatës së Apelit të Kosovës, kërkesë të cilën Gjykata e shpalli të papranueshme përmes Aktvendimit për Papranueshmëri në rastin KI141/14.
14. Më 28 tetor 2015, parashtruesi i kërkesës për herë të dytë parashtrroi kërkesë në Gjykatë, për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [CML. nr. 6/2014] të Gjykatës Supreme të Kosovës, kërkesë të cilën Gjykata e shpalli të papranueshme përmes Aktvendimit për Papranueshmëri në rastin KI129/15.
15. Më 19 qershor 2017, parashtruesi i kërkesës për herë të tretë parashtrroi kërkesë në Gjykatë, për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit [CPP. nr. 2/2017] të Gjykatës Supreme, kërkesë të cilën Gjykata e shpalli të papranueshme përmes Aktvendimit për Papranueshmëri në rastin KI70/17.
16. Më 24 janar 2020, parashtruesi i kërkesës për herë të katërt parashtrroi kërkesë në Gjykatë, për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Rev. A.U. nr. 7/ 2019] të Gjykatës Supreme, kërkesë të cilën Gjykata e shpalli të papranueshme përmes Aktvendimit për Papranueshmëri në rastin KI17/20.
17. Më 8 janar 2021, parashtruesi i kërkesës për herë të pestë parashtrroi kërkesë në Gjykatë, për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [AC-I-15-0211-A0001] të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, kërkesë të cilën Gjykata e refuzoi me procedurë të shkurtër përmes Vendimit për refuzim në rastin KI03/21.
18. Parashtruesi i kërkesës, në rastin konkret, i drejtohet Gjykatës për herë të gjashtë.
19. Nga shkresat e lëndës rezulton se, në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit [CN. nr. 94/2020] të Gjykatës së Apelit, me të cilin ishte hedhur poshtë si i palejueshëm propozimi i parashtruesit të kërkesës për përsëritjen e procedurës, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore.
20. Më 14 gusht 2023, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [Ac. nr. 332/2022] refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin [CN. nr. 94/2020] e 10 qershorit 2021 të Gjykatës së Apelit. Në arsyetimin e aktvendimit të saj, Gjykata e Apelit theksoi se aktvendimi i atakuar nuk ishte i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Në këtë drejtim, Gjykata e Apelit shtoi se në aktvendimin e atakuar ishin arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për hedhjen poshtë si të palejuar të propozimit të parashtruesit të kërkesës për përsëritjen e procedurës, në përputhje me paragrafin 1 të nenit 68 të LPP-së.

21. Nga shkresat e rastit rezulton se, më 5 dhjetor 2023, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Zyrën e Prokurorit të Shtetit kundër Njoftimit [KMLC. nr. 119/23] të Zyrës së Prokurorit të Shtetit të 2 nëntorit 2023. Në lidhje me këtë ankesë, më 6 dhjetor 2023, Zyra e Prokurorit të Shtetit, përmes Njoftimit [KMLC. nr. 119/23], njoftoi parashtruesin e kërkesës se nuk ka bazë ligjore për iniciimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.
22. Nga shkresat e rastit më tutje rezulton se parashtruesi i kërkesës sërish ka dorëzuar në Zyrën e Prokurorit të Shtetit shkresë përmes së cilës ka kundërshtuar Njoftimin [KMLC. nr. 119/23] të Zyrës së Prokurorit të Shtetit të 28 dhjetorit 2023, si dhe disa njoftime të mëhershme, të cilat parashtruesi i kërkesës nuk ia ka bashkëngjitur kërkesës së tij para Gjykatës.
23. Më 24 janar 2024, Zyra e Prokurorit të Shtetit, përmes Njoftimit [KMLC. nr. 119/24], lidhur me kërkesën e parashtruesit të kërkesës, njoftoi të njëjtin se nuk mund të iniciohet kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë. Nga shkresa e lartcekur rezulton se parashtruesi i kërkesës pranë Zyrës së Prokurorit të Shtetit ka dorëzuar shkresa të tjera, përmes të cilave ka kundërshtuar Njoftimin [KMLC. nr. 119/23] e 28 dhjetorit 2023, si dhe njoftimet tjera të mëhershme. Në lidhje me këtë, përmes shkresës së lartcekur të Zyrës së Prokurorit të Shtetit u theksua se *“Për shkak të sqarimit të këtij rasti, sipas kërkesës së palës kemi pranuar palën në takim me bashkëpunëtorin profesional të çështjes për të diskutuar rreth pretendimeve të paraqitura në shkresë, edhe përkundër asaj që edhe më parë e kemi njoftuar përmes shkresave zyrtare në lidhje me rastin”*.
24. Më 30 prill 2024, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e propozuar nga gjyqtari raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës ta refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës nuk specifikon aktin e autoritetit publik të cilin e konteston dhe as nuk qartëson saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutë pretendon se i janë cenuar.
26. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesë për njohjen e të drejtës për kompensim të diferencës në pagë për periudhën nga 1 tetori 2008 deri në janar të vitit 2020, duke përfshirë kamatën ligjore.
27. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës thekson se me reformën e arsimit në vitin 2007, vendet për arsimtarë ishin zvogëluar nëpër shkolla *“Por Marrëveshja në mes Qeverisë dhe SBASHK-ut ka qenë që të diplomuar-të kualifikuarit për vendet që kanë qenë në punë të sistemohen dikund ku ka mundësi. Ata të Komunës-Dak-ja nuk më sistemoi askund. [...]”*.
28. Tutje, parashtruesi i kërkesës shton se pas kërkesës pranë KPMK-së, kjo e fundit vendosi që ta kthejë atë në vendin e mëparshëm të punës ose në ndonjë vend ku i përgjigjet kualifikimi. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës thekson se Komuna e Prishtinës e sistemoi parashtruesin e kërkesës në pozitën e punës ‘bibliotekist’ për kohë të caktuar, dhe se pavarësisht kërkesave të tij, nuk e kthyen më në vendin e mëparshëm të punës. Parashtruesi i kërkesës shton se, në këtë pozitë, paga kishte qenë më e ulët për 200 euro dhe se: *“Diferencën e pagës e kam lyp nga DKA-ja nga Gjykata e deri sot asgjë. Ja vendimi i Gjykatës Cp. Nr. 27818/19 ku thotë se e ka marrë diferencën ku nuk është e vërtetë se unë kam marrë 13 paga sa kam qenë i papunë 3750 euro. A për diferencë asnjë cent. Sikurse*

Gjykata Themelore ashtu ka thënë Gjykata e Apelit me nr. 2022:009306 që e kam marrë me datën 22.9.2023.”

29. Parashtruesi i kërkesës tutje shton: *“Nenet nuk po i ceku se nuk po kam durim ti shikoj dhe ti analizoj, ju duhet ti shikoni pasi jeni institucion që e doni të drejtën njerëzore dhe ligjore të cilat janë të përafërta në mes veti [...]”*.
30. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson se nuk e ka ditur pagën e bibliotekistit, përkatësisht se ajo është më e vogël se e mësimdhënësit, për arsye se në kontratën e punës nuk ka qenë e specifikuar.
31. Në fund, parashtruesi i kërkesës shton se: *“Sipas vendimit të Gjykatës Themelore në lëndën E nr.2433/11 që thotë se unë kam marrë diferencë nuk është e VËRTET, por është gënjeshtër e kulluar, por unë sipas kësaj lënde dhe sipas vendimit të KPMK kam marrë 13 paga që kam mbetur jashtë sistemit të punës kam marrë 3750 euro nga i pari 1.9.2007 deri me 1.10.2008 kur më kanë kthye në punë Komuna sipas vendimit të KPMK të 2008 ku ky vendim nuk është zbatuar në tërësi. Kurse për diferencë nuk kam marrë asnjë cent. Prandaj, po kërkoj diferencën së bashku me kamatë ligjore nga 1.10.2008-31.1.2020. I kam shterrë të gjitha mjetet juridike pastaj jam paraqitur në Kushtetuese si p.sh. Gjykatës Supreme për përsëritje të procedurës përmes së Apelit, Prokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial. Ju keni mundësi të më ndihmoni”*.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

32. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
34. Gjykata, po ashtu i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale) dhe 48 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 (Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

35. Në kontekst të dispozitave të lartcekura, Gjykata thekson se bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 1 të nenit 47 dhe nenin 48 të Ligjit, parashtruesit e kërkesave duhet të specifikojnë aktin konkret të autoritetit publik që kontestohet dhe gjithashtu janë të detyruar që të qartësojnë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendojnë se u janë cenuar.
36. Në rastet kur kërkesa nuk i përmbush kriteret kushtetuese dhe ligjore të pranueshmërisë, Ligji dhe Rregullorja e punës përcaktojnë procedurën që duhet ndjekur nga Gjykata në mënyrë që parashtruesit të kërkesës t'i jepet mundësi për të kompletuar dhe plotësuar kërkesën e tij.
37. Në lidhje me këtë, Gjykata, përmes shkresës së 22 shkurtit 2024, kishte kërkuar nga parashtruesi i kërkesës që të njoftojë Gjykatën se (i) cilin vendim të autoritetit publik e konteston para Gjykatës; (ii) të specifikojë se cilat të drejta dhe liri kushtetuese pretendon se i janë cenuar; si dhe (iii) të dorëzojë vendimin e fundit të kontestuar së bashku me vendimet tjera apo dokumentet e nevojshme që kanë të bëjnë me këtë kërkesë.
38. Në vijim të kërkesës së Gjykatës, parashtruesi i kërkesës, më 4 mars 2024, përmes përgjigjes së dorëzuar në Gjykatë, theksoi se kërkon kompensimin e diferencës në pagë si dhe bashkëngjiti disa dokumente shtesë. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk specifikoi se cilin akt të autoritetit publik e konteston dhe as nuk saktësoi se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutë i janë cenuar dhe se si kishte ardhur deri tek shkelja e tyre.
39. Në këtë aspekt, dhe duke marrë parasysh atë që u cek më lartë, Gjykata në bazë të Rregullores së saj të punës, mund të refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.
40. Në dritë të këtyre fakteve, Gjykata i referohet pikës (a) të paragrafit 2 të rregullit 54 (Hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“[...]

(2) Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se:

(a) kërkesa është jo e plotë ose e paqartë, përkundër kërkesës ose kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose të qartësojë kërkesën;

[...]”.

41. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij fillestare dhe në përgjigjen e 4 marsit 2024, përmend disa vendime të gjykatave të rregullta, mirëpo nuk specifikon se cilin

e konteston para Gjykatës dhe as nuk saktëson se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutë i janë cenuar, siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit. Për më tepër, në përgjigjen e 4 marsit 2024, parashtruesi i kërkesës thekson: *“Pasi mi keni kërkuar disa dokumente dhe po ua dërgoj, dhe njëherit po ju tregoj nuk po kërkoj tjetër vetëm diferencën prej 1.10.2008 e deri me 31.1.2020 pasi që më takon diferenca në mes bibliotekistit dhe profesorit”*.

42. Në lidhje me këtë, Gjykata rithekson se barra për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën bie mbi parashtruesit e kërkesës, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në mënyrë që pohimet dhe pretendimet e tyre të adresohen në mënyrë efektive nga Gjykata. Në rastet kur parashtruesit e kërkesës nuk i përgjigjen kërkesës së Gjykatës për qartësimin dhe plotësimin e kërkesës, Gjykata i deklaron këto kërkesa si të paqarta dhe jo të plota, dhe si rezultat nuk i shqyrton pretendimet e parashtruesit të kërkesës (shih, rastet e Gjykatës, [KI13/23](#), parashtruese *Marigona Dorđević-Jakaj*, Vendim për refuzim të kërkesës i 29 gushtit 2023, paragrafi 22; [KI08/22](#), parashtrues *Bajram Santuri*, Vendim për refuzim të kërkesës, i 6 korrikut 2022, paragrafi 38; dhe [KI101/21](#), parashtrues *N.T.SH. Morina B*, Vendim për refuzim të kërkesës, i 8 shtatorit 2021, paragrafi 36).
43. Si përfundim, Gjykata, në bazë të nenit 48 të Ligjit dhe pikën (a) të paragrafit 2 të rregullit 54 (Hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) të Rregullores së punës konstaton se kërkesa është e paplotë dhe e paqartë dhe duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, në nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 54 (2) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 30 prill 2024, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën me procedurë të shkurtër;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues


Enver Peçi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani